



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 24, datë 11.06.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: “STRUKTURË BANIMI 1, 2, 3, 6 DHE 7 KATE MBI TOKË, ME 1 KAT PARKIMI NËNTOKE” ME VENDNDODHJE NË BASHKINË SARANDË

Në mbështetje të neneve 27, 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Fabbeno 2015” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Strukturë banimi 1, 2, 3, 6 dhe 7 kate mbi tokë, me 1 kat parkimi nëntoke”, me vendndodhje në Bashkinë Sarandë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Fabbeno 2015” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
Enea Karakaçi



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TERRITORIT

Adelajda Roka



Nënshkruar më datë 25/03/2026